

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/20/a-ishte-paralajmruar-denimi-i-ish-krereve-te-uck-se-kryeprokurori-i-speciales-me-2020-do-burgosen-perjete/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 07:18:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 07:12:21 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	db0cd7a028bb5b77cf24cd38ab385d63109db65b5437e531afb9dd9d7905d6f1a
TEKSTI	82c94ee9c416643335e63f8aafd4da4f8a5a584a66e77875f22f6856563c441d
PAMJA	fdea13d2bbdfd3804e2b47dad0348c708e2df08bb7cfe2a4f5af49d86a032a85

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1e8a2ff8e69c285dd9883b3790d680a8bfd3a91afd94a19b9bfb7b4fc6aa7c7c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b7b490a69c70e21e2941949443c05c93b4bd86b11849ed3235586ee33bac8ed0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1e8a2ff8e69c285dd9883b3790d680a8bfd3a91afd94a19b9bfb7b4fc6aa7c7c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë

Kryesore

Publikuar: 20/09/2026



Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit mund të jetë paracaktuar që në fillimet e procesit gjyqësor në Hagë.

Këtë përshtypje e përforcon një dokument, i cili zbardh prapaskenat e një takimi të mbajtur më 7 dhe 8 dhjetor 2020, vetëm një muaj pas arrestimit të katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në seancën informuese të mbajtur larg syrit të opinionit publik dhe pa asnjë komunikatë zyrtare, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, bashkë me ish-Kryeprokurorin e Specializuar Jack Smith dhe Regjistruesen Fidelma Donlon, u takuan me ambasadorë e diplomatë të akredituar në Kosovë, ndërsa takime të ngjashme u zhvilluan edhe në Hagë e Beograd.

Gjatë këtij takimi 'sekret', ish-Kryeprokurori Jack Smith u shpreh me një gjuhë të ashpër dhe të prerë, duke deklaruar **me bindje të plotë se të akuzuarit do të dënohen me burgim të përjetshëm**. Sipas dokumentit, Smith pretendon se aktakuza e tij mbështetet në çdo fjalë të provat e dëshmitarët për "qindra viktima të torturuara e të vrara në qendrat e ndalimit", ndërsa denoncoi atë që e quajti "përpjekje të Thaçit dhe Veselit për të penguar punën e Prokurorisë".

Ai u kërkoi diplomatëve mbështetje publike, dërgimin e personelit shtesë hetimor. Rrethanat rëndohen pasi Kryetarja e Gjykatës, Ekaterina Trendafilova, e pranishme në takim, nuk bëri asnjë reagim ndaj deklaratave të Smithit, që cenojnë rëndë parimin e prezumimit të pafajësisë.

Me të lexuarat

Dy turistë suedeze në Tiranë: Ftuam në shtëpi 3 djem, ata na përdhunuan, bapci juaj i fiktiv



tenderave të dyshimtë pas lirimit nga burg, në skenë Etien



Si do i pastrojnë Chafaj i Post paratë e korrupsionit me tendera në ndërtim, bashkëshortja



hap dy "imperien" sërisht Bashkim Ulajn - Në kulmin e protestave për Rrjollin,



Danijskërit nga operacioni antidroge, mes të akuzuarve edhe aktori i njohur i serialit "Çuku..."




parimi e prezimit të parjesë.

Nga ana e saj, Trendafilova bëri një përmbledhje të zanafillës së gjykatës nga libri i Carla del Ponte-s, raporti i Dick Marty-t dhe gjetjet e Ekipit Hetimor Special (SITF), duke sqaruar se selia ndodhet jashtë Kosovës për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe se ndjekja penale lidhet vetëm me përgjegjësinë individuale e jo me UÇK-në si organizatë apo ushtri.

E pyetur nga Ambasadori Gjerman përse në sallën e gjyqit nuk shfaqen flamuri dhe simbolet shtetërore të Kosovës – çështje e ngritur edhe nga mbrojtja e Thaçit – Trendafilova u përgjigj se institucioni financohet nga BE-ja e donatorët dhe përbëhet nga profesionistë ndërkombëtarë. Ajo e cilësoi ngritjen e kësaj teme nga avokatët si një provokim me qëllim të pastër politik për të krijuar debat në Kosovë e për të delegjitimuar Dhomat e Specializuara.

Ndërsa, në fjalën e saj Regjistruesja Fidelma Donlon garantoj se “institucioni zbaton standardet më të larta ndërkombëtare për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe garantimin e të drejtave të të akuzuarve”.

Kujtojmë se ish-krerët e UÇK-së u dënuan nga Gjykata e Hagës me 81 vite burg në total. Hashim Thaçi u dënua me 25 vite burg, Jakup Krasniqi me 25 vite, Kadri Veseli me 18 dhe Rexhep Selimi me 13 vite burg. Vendimi u prit me indinjatë nga shqiptarët, që nënvizojnë se krerët e UÇK-së luftuan për lirinë e Kosovës. Vendimi është i shkallës së parë dhe do apelohej./Tv Klan



TAG:

Gjyqi në Hagë

Hashim thaçi

Jakup Krasniqi

Rexhep selimi

Të ngjashme



Safet Gjici u rikthehet tenderave të dyshimtë pas lirimit nga burgu, në skenë Etjen Xhafaj i Postës, ish kryebashkiaku mbi 100 milionë euro kontrat...

Qeveria “shpërblen” sërisht Bashkim Ulajn - Në kulmin e protestave për Rrjollin, biznesmeni mori leje për resort në Jalë!

Dy turiste suedeze në Tiranë: Ftuaam në shtëpi 3 djem, ata na përdhunuan, pastaj ftuaam 2 të tjerë, edhe ata na përdhunuan (pas 3 ditësh bënë kallëzim)

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË

KRYESORE POLITIKË EKONOMI

ANALIZË RAJON KULTURË SPORT



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.